



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:242400  
Datë: 16.10.2024  
Numri i dokumentit: 06308805

C.nr.681/2019

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË- DEGA NE VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Leotrim Gashi, në procedurën kontestimore sipas padisë së paditësit V.H, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Studio e Avokatisë “Avokatura A-R” kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Dukagjini”, me objekt kontesti kompensim dëmi, jashtë seancës, më datë 16.10.2024, mori këtë

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET SE ËSHTË TËRHEQUR padia C.nr.681/2019, e datës 08.10.2019 e paditësit V.H, ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” me objekt kontesti kompensim dëmi.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi, me datë 08.10.2019, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar Studio e Avokatisë “Avokatura A-R”, ka paraqitur në këtë gjykatë padinë ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” për kompensim dëmi lidhur me aksidentin e shkaktuar me datë 22.06.2019, nga i siguruari i të paditurës G.D.

Gjykata lidhur me këtë çështje e ka caktuar seancën përgatitore me datë 15.10.2024 në ora 14:30 dhe sipas flet kthesës së pranuar në gjykatë me datë 02.10.2024, si i autorizuari i paditësit ashtu edhe e paditura ftesën për seancë e kanë pranuar në mënyrë të rregullt me datë 30.09.2024 mirëpo mungesën për seancë nuk e ka arsyetuar asnjëra nga palët.

Gjykata ka pritur për 15 minuta, mirëpo deri në ora 13:45, në seancë nuk ka prezantuar përfaqësuesi i autorizuar i paditësit e as e paditura, andaj gjykata, duke u bazuar në nenin 409, par 1 të Ligjit nr. 03/L-006 të Procedurës Kontestimore (LPK), sipas të cilit thuhet se “Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet”, gjykata ka marrë aktvendimin si në dispozitivin I, të këtij aktvendimi, me të cilin vendim padia e paditësit është konsideruar e tërhequr.

Gjykata vendosi si në dispozitivin II, të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2019:242400, C.nr.681/2019, me datë 16.10.2024**

**G j y q t a r i**

---

**Leotrim Gashi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.